




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 684/24-0210  
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. 1/4  
Data/Datum/Date: 15.10.2024.  
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA



Nr. 94/24  
Prishtinë, më 15.10.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6, neni 39, si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 08/2023 për Përcaktimin e Keqpërdorimit të Pozitës Dominuese ka shqyrtuar propozim/ kërkesën e datës 17.04.2024, nga Burimi Petrol, Beki Benz dhe Albi Oil, kundër ndërmarrjes Ada Gas. në mbledhjen e mbajtur me datën 15.10.2024 pas shqyrtimit të raportit të sekretariatit, merr këtë:

### KONKLuzion

Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatohet se nuk ka argumente për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj operatorit të naftës ADA GAS në Gjilan.

### Arsyetim

#### Pretendimet e ankuesit:

Burimi Petrol, Beki Benz dhe Albi Oil me 17 Prill 2024, ka deponua një ankese në Autoritetin e Konkurrencës kundër "ADA GAS" sh.p.k, me numrin Unik Identifikues 810273409.

Sipas palës ankuese, dyshohet se ka shitje të derivateve me pakicë me çmime nën kosto të cilat janë duke ndodhur nga ndërmarrja "ADA GAS", të cilat si çmime janë tërësisht të pambulushme dhe jashtë çdo logjike të importit sepse sipas palës ankuese, vendi i furnizimit është pothuajse i njëjtë për të gjitha pikat dhe si e tillë nuk mund të jetë aq i lirë për ndërmarrjen "ADA GAS" në raport me ndërmarrjet e tjera. Sipas palës ankuese, çmimi i furnizimit është 1.26€ kurse çmimi sot është 1.22€. Ky fenomen po ndodh vetëm në Gjilan, dhe bizneset janë shumë të dëmtuara sepse disa nga bizneset në fjalë po shesin me çmime nën kosto. Sipas ankuesve, kompanitë të cilat shesin derivate nën kosto janë, Ada Gas, Euro Mit, Veda edhe Hib Petrol. Kemi dy vite që jemi në këtë gjendje, për shkak të Ada Gas dhe Veda, kurse kohës së fundit ka filluar edhe Hib Petrol, ku sipas pretenduesit shesin me çmime nën kosto. Nëse e bëje krahasimin me qytetet më të afërta, shembull me Vitin, atje çmimi momental është 1.38€ kurse në Gjilan 1.22€, teritor ky shumë i afërt gjeografikisht. Ada Gas çmimin me shumicë të furnizimit e kemi 1.22€ për 10.000 (dhjetë mijë litra) litra, kurse çmimin me pakicë e shesin me çmim 1.24€.

## Objekti i shqyrtimit paraprak

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, ka filluar hulumtimet lidhje me shqyrtimin paraprak në tregun përkatës, bazuar në dispozitat ligjore, përkatësisht nenit 5 me nën paragrafët 1.1, 1.2,1.3,1.4 dhe 1.5, neni 8 me paragrafët 1 dhe 2 nën paragrafët 1,1 dhe 1,2, neni 9 me paragraf 1 dhe 2 si dhe nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-056 LMK-së.

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë monitorimit të tregut ka pasur dyshimin se:

1. **Ada Gas**, me numrin Unik Identifikues 810273409 me adresë në Komunën e Gjilanit; 2. **Euro Mit** me numrin unik identifikues 810652554 me adresë në Komunën e Gjilanit; 3. **Veda** me numrin unik identifikues 810674433 me adresë Komunën e Gjilanit; 4. **Hib Petrol** me numrin unik identifikues 812030493 me adresë në Komunën e Gjilanit; me dyshimin për marrëveshjet e ndaluara nga neni 5 dhe keqpërdorimin e pozitës dominuese nga neni 8 të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## Të dhënat e grumbulluara gjatë shqyrtimit paraprak në tregun relevant

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, ka filluar monitorimin e tregut duke u bazuar në ankesën e dt. 17.04.2024, me pretendimin e operatoreve të tregut horizontal, për shitjen e derivateve përkatësisht produktit naftë me çmime nën kosto. Andaj, Autoriteti pas mbledhjes së informatave lidhur me pretendimet për keqpërdorimin e pozitës dominuese në tregun e derivateve, hulumtimin e tregut përkatës përkatësisht në Komunën e Gjilanit, monitorimin e të gjitha lëvizjeve që kanë të bëjnë me importet, shitjet me pakic dhe me shumicë, shpenzimeve tjera që ndikojnë në çmimin e shitjes.

Autoriteti pas marrjes së autorizimit për fillimin e mbledhjes së të dhënave dhe hulumtimit të tregut të produktit dhe tregut përkatës, ka zhvilluar një seri aktivitete, duke filluar nga ndërmarrjet ankuese, po ashtu edhe një seri takimesh me operatorët e derivateve të naftës në Komunën e Gjilanit.

Poashtu, sekretariati i AKRK-së ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e shoqatës së naftëtarëve, dhe kryeinspektorin e MINT me dt. 20.05.2024.

Gjithashtu, ka pasur komunikim të vazhdueshëm deri tek mbledhja e të dhënave lidhur me listimin e pikave (ndërmarrjeve) të derivateve që operojnë në territorin administrativ të Komunës së Gjilanit.

## Analiza e Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga administrata shtetërore dhe entet rregullatore në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj



ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me pozitë dominuese, si dhe përqendrimit që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg

Lidhur me pretendimet se ndërmarrjen Ada Gas SH.P.K ka keqpërdor pozitën dominuese lidhur me vendosjen e çmimeve të shitjes nën çmimin kushtues, Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar sjelljen e kësaj ndërmarrjeje në treg nga këndvështrimi e rregullave të konkurrencës konkretisht lidhur me çmimet nën çmimin e koston, duke e marrë parasysh çmimet e blerjes dhe çmimet e shitjes.

Autoriteti i Konkurrencës bazuar në nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës ka monitoruar ndërmarrjen Ada Gas SH.P.K për shkak të shqetësimeve të ngritura nga Burimi Petrol, Beki Benz dhe Albi Oil dhe Oda e Naftëtarëve të Kosovës lidhur me pretendimin për keqpërdorim të pozitës dominuese për shkak se ndërmarrjen Ada Gas SH.P.K kishte vendosur çmim të shitjes nën çmimin kushtues. AKRK, ka nxjerrë strukturën e tregut të kësaj ndërmarrjeje, në bazë të analizave del se ndërmarrjen Ada Gas SH.P.K ka këtë strukturë të tregut, që konsiderohet Pozitë Dominuese në territorin e Komunës së Gjilanit.

Autoriteti në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe gjendjes faktike të konstatuar gjatë ekzaminimit paraprak të situatës në tregun përkatës, ka hulumtuar dhe analizuar të gjithë aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve sipas tregut gjeografik dhe të produktit, në mënyrë që ta ketë një pasqyrë të qartë të mbrojtjes së konkurrencës dhe zhvillimit të saj të drejtë dhe ligjore ndërmjet konkurrentëve dhe konkurrencës!

Për ta konstatuar keqpërdorimin e pozitës dominuese, duhen dëshmi e fakte të prekshme se cilët nga paragrafët dhe nen paragrafët të nenit 9 të LMK janë shkelur nga ndërmarrja.

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas fillimit të monitorimit, respektivisht shqyrtimit paraprak, ka bërë mbledhjen e të dhënave lidhur me identifikimin e tregjeve, përkatësisht tregun e derivateve të naftës në komunën e Gjilanit.

Gjatë hulumtimit grupi i punës ka analizuar dhe përpunuar të dhënat e marra nga ndërmarrjet, MINT në të cilat raportojnë këto ndërmarrje dhe bazuar në të dhënat e siguruara ka arrit në përfundim të shqyrtimit paraprak të kësaj lënde.

Nga ajo se çka u potencuar më sipër, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që ndërmarrja ADA GAS SHPK, ka keqpërdorur me pozitën e saj dominuese në tregun në fjalë, duke zbatuar politika të shitjes nën çmimin kushtues apo edhe duke përdorur kushte të ndryshme për transaksione të natyrës së njëjte në kuptim të nenit 9, paragrafi 2, nën paragrafët 2.3, 2.5 dhe 2.6 dhe nenit 5 të LMK-së. Dëshmi lidhur me konstatimin e sipër cekur mund të marrim edhe analizën e shitjeve të periudhës TM4 2023 si dhe periudhën Janar- Prill 2024, ku janë nxjerr shitjet me pakicë dhe shitjet me shumicë e pastaj si të tilla janë krahasuar me kostot e importit, gjithashtu është trajtuar edhe çështja e shpenzimeve indirekte të cilat në rrethana kur shitja në litra është shumë e lartë bëhen lehtë të përballueshme pavarësisht marzhës së fitimit bruto për litër që mund të jetë më e vogël.

Gjithashtu, gjatë mbledhjes së të dhënave faktë tjetër i rëndësishëm është që ndërmarrjet ndaj të cilave është kriju dyshimi mbi marrëveshje për fiksime të çmimeve nuk i kanë çmimet e njëjta për ditë të njëjta të shitjes dhe zakonisht ato kanë çmime konkurruese përcjellëse ndaj ndërmarrjeve në tregun përkatës dhe të produktit, dhe si i tillë nuk ka fakte të mjaftueshme për marrëveshje të ndaluara.

Grupi i punës bazuar në LMK-ja dhe praktikave tregtare dhe rasteve të trajtuara të ngjashme tregojnë qartë se të qenurit në pozitë dominuese nuk bij ndesh me ligjin për mbrojtjen e konkurrencës por abuzimi me pozitën dominuese është shkelje e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe udhëzimeve administrative

si akte normative të saj. Gjatë trajtimit të lëndës, Autoriteti ka marrë për bazë dokumentacionin duke filluar nga lënda e parë ku është trajtuar çdo dokument unik doganor përmes së cilës grupi i punës ka arritur të gjejë çmimin e furnizimit, të trajtuar si kosto direkte, pas të cilit ka bërë i ka bashkangjitur edhe çmimet e shitjes të ndara në shitje me pakicë dhe shitje me shumicë si dhe ka bërë edhe trajtimin e kostove indirekte siç janë lista e pagave dhe shpenzimet tjera përcjellës nga raportet financiare të ndërmarrjes në fjalë.

Siç u përmend më sipër, pas analizës mujore të secilës shitje dhe trajtimit të çdo kostoje dhe stokut të mbetur, grupi i punës konstaton se çmimi mesatar i shitjes nuk është më i ulët se kostoja e mallit të shitur. Për më tepër, marzha e konstatuar nga grupi i punës është e ngjashme me raportet financiare të deklaruara nga përfaqësuesit e ndërmarrjes gjatë takimeve të mbajtura në shqyrtimin paraprak, që nënkupton se ndërmarrja nuk ka operuar me humbje dhe nuk ka pasur çmime nën kosto, që poashtu vlen të theksohet se raporti i sekretariatit është i krahasueshëm me raportin e auditimit sa i përket gjenerimit të të hyrave dhe fitimit në fund të vitit.

Autoriteti do ta bëjë monitorimin e tregut përkatës edhe në të ardhmën dhe kurdo që do të identifikoj shkelje, do të veproj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

## AUTORITETI I KONKURENCËS

### Komisioni

Neime Binaku - Isuf  
Kryetare



Kaltrina Sela  
Nënkryetare




Florent Mehmeti  
Anëtar



Nafije Osdataj  
Anëtare



Salihe Gashi Loku  
Anëtare



**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva